

Andi Muratej

Andi Muratej ushtron detyrën e Këshilltarit në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve, Departamenti i Shërbimeve Ligjore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë prej muajit Shtator 2019.

Është diplomuar në vitin 2001 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me rezultate të larta. Gjatë studimeve dhe deri në vitin 2004 është angazhuar dhe ka punuar në projekte të ndryshme të zbatuara nga organizata jofitimprurëse si, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), “Intelektualët e Rinj, Shpresë”, etj., me fokus monitorimin e sistemit të burgjeve, sistemit gjyqësor, zgjedhjeve të lira, etj. Në vitin 2002 ka marrë titullin “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Në vitet 2004-2014 ka ushtruar detyra të ndryshme në administratën publike në institucione shtetërore qendrore dhe të varësisë si, Ministria e Drejtësisë, Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, në funksionet specialist, përgjegjës sektori, inspektor, inspektor jurist dhe avokat i shtetit.

Në vitet 2014-2018, z. Muratej ka punuar si Menaxher dhe Koordinator Projekti, Ekspert si dhe Avokat pranë KShH, në programe dhe projekte me fokus respektimin e të drejtave të njeriut në përputhje me Kushtetutën, Konventat Ndërkombëtare, legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë kësaj eksperience, për t’u theksuar është puna për përfaqësimin ligjor të organizatës në çështjet gjyqësore të litigimit strategjik për çështje që lidhen me, ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues, ndalimin e burgimit të paligjshëm, respektimin e procesit të rregullt ligjor, ndalimin e diskriminimit, përgatitjen e Studimit lidhur me “Veprat penale të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues si dhe praktika e hetimit dhe gjykimin të tyre në rrethet gjyqësore Tiranë dhe Elbasan”, të Raportit Studimor për denoncimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, të Raportit lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, të raporteve periodike lidhur me gjëndjen e të drejtave të njeriut në vend drejtuar institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare dhe rajonale si CAT, ECRI, Bashkimi Europian, Departamenti i Shtetit, etj., të Raporteve vjetore mbi situatën e të drejtave të njeriut të KShH, etj.

Pjesë e rëndësishme e punës pranë KSHH ka qënë dhe menaxhimi i projekteve për monitorimin e zgjedhjeve për kuvendin apo zgjedhjeve vendore, nga faza parazgjedhore deri në përgatitjen e raportit përfundimtar, monitorimi i

respektimit të të drejtave dhe trajtimit të personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë, paraburgime dhe burgje, përgatitja e raporteve dhe rekomandimeve për shkeljet e konstatuara, etj.

Në vitet 2018 –2019 ka punuar si Ekspert ligjor, Avokat dhe Koordinator Projekti pranë Shoqatës “Together for Life”, shoqatë e cila punon për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndalimin e diskriminimit, barazinë gjinore, mbrojtjen e shëndetit, mirëqeverisjen, mbrojtjen e grupeve vulnerabël, etj. Ajo është pjesë e rrjeteve rajonale si Rrjeti i Qytetarisë Aktive Evropiane, Rrjeti i Zërit të të Rinjve, Rrjetit kundër Gjuhës së Urrejtjes, Rrjetit Mjedisor “ECIM” si dhe Koalicionit “Drejtësi për të Gjithë”.

Në vitin 2004, z. Muratej ka përfunduar Kursin Pas-universitar mbi “Planifikimin, Drejtimin dhe Vlerësimin e ndërhyrjes publike në kuadër të reformës në sistemin e Qeverisjes Lokale”, të realizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në bashkëpunim me CEFAL Bolonja, Universitetin Roskild dhe Universitetin e Bolonjës, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, Programi TEMPUS.

Në vitin 2006, ka përfunduar Programin Lider për Studime të Avancuara të Sigurisë, të zhvilluar në Qendrën Evropiane për Studime të Sigurisë “George C. Marshall”, Garmisch-Partenkirchen, Gjermani.

Ndërsa, në vitin 2008 ka përfunduar Kursin e Lartë për Studime në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes pranë Kolegjit Rajonal Shqiptar të Mbrojtjes, Akademia Shqiptare e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes, Tiranë. Ky kurs është ekuivalentuar sipas Çertifikatës në Sigurinë Civile Ndërkombëtare, lëshuar nga Universiteti i Kolorados në Kolorado Springs (ShBA).

Gjatë eksperiencave të mësipërme në administratën publike, në sistemin gjyqësor si dhe në shoqërinë civile, z. Muratej ka marrë pjesë në shumë trajnime, konferenca dhe seminare, brenda dhe jashtë Shqipërisë, me tematika të ndryshme të lidhura me sistemin e drejtësisë, të drejtat e njeriut dhe Shtetin e së Drejtës, mbrojtjen e mjedisit, aksesin në drejtësi dhe drejtësinë për të mitur, të drejtat e fëmijëve, monitorimin e sistemit gjyqësor, të sistemit të burgjeve, luftën kundër korrupsionit, dhunën në familje, dënimet alternative ndaj burgimit, Shërbimin e Provës, Kodin Zgjedhor, reformën në sistemin e paraburgimit, pushtetin lokal, mirëqeverisjen, etj.

Është njohës shumë i mirë i gjuhëve Anglisht dhe Italisht.